



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË**

V E N D I M

Nr.24.dt.03.03.2000

**MBI
MIRATIMIN E ANKESAVE PER DHENIEN E LEJEVE TE NDERTIMIT NGA
K.RR.T**

Këshilli i Bashkisë i Tiranës i mbledhur në dt.03.03.2000 pasi shqyrtoi ankesat e disa qytetarëve duke u mbështetur në ligjin nr.7572 dt.10.06.1992 ndryshuar me numër 8068 dt.15.02.1996 dhe numër 8138 dt.31.07.1996 neni 14 pika 12, 16 “Për organizimin dhe funksionimin e Pushtetit Lokal” si edhe ligjin numër 8-15 dt.19.10.1995 neni 12 “Për disa ndryshime në ligjin numër 7693 dt.26.04.1993 për urbanistikën dhe pasi dëgjuam propozimin e komisionit të zhvillimit urban dhe ndërtimeve

V E N D O S I

1. Kërkesa e Z. Bastri Kastrati për rishqyrtim nga K.RR.T leje ndërtimi objekt 3 kat në pronën e tij
Miratohet propozimi komisionit të zhvillimit urban, të rishqyrtohet në K.RR.T sepse i interesuari është gati ti përgjigjet në të ardhmen cdo kërkesë që do të rrjedhë nga studimi urbanistik i qendrës së Tiranës
2. Kërkesë ankesa e Z. Roland Tasho i cili ankohet për vendimin e K.RR.T për mbylljen e një dritareje, në dhomën e marrë me qira prej tij dhe hapjen në një faqje tjetër
3. Kërkesa e Znj. Irena Laha për ridiskuktimin në K.RR.T për godinë 3 kate prapa Ekspozitës “Shqipëria Sot”

Miratohet propozimi i komisionit duke u paraqitur në K.RR.T, të mundësohet edhe shikimi në vend nga një komision i zyrës së urbanistikës, siç është vendosur më parë

4. Kërkesa e Znj. Fize Tumani për një ndërtim 1 katësh në rrugën “Bardhyl”
Miratohet propozimi i komisionit që të rishqyrtohet në K.RR.T, sepse është e ndryshme nga kërkesa e parë e refuzuar, e bërë nga pronari i mëparshëm
5. Kërkesa e Z. Guxim Resuli, për një ndërtim 1 katësh, përbri apartamentit të tij
Miratohet propozimi i komisionit që të ridiskutohet në K.RR.T
6. Shresa me nr.13169 dt.24.12.1999 nga Këshilli i Ministrave (Sektori i Marrdhënieve me Publikun) lidhur me kërkesën e banorëve të pallateve 250, 231 e 236 të Rr. Mine Peza
7. Kërkesa e Z. Sefer Cumanit për shtesë kati në pallatin që është përbri pallatit 8, në rrugën “Mihal Grameno”
Miratohet propozimi i komisionit që të rishikohet kërkesa për ngritje kati në K.RR.T
8. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Urbanistikës
9. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

KRYETARI

ORHAN SAKIQI

